[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË | VITI IX - NR. 89 (2612) | E ENJTE, 18-04-2019 | www.shqiptarja.com

SONDAZHI I RI I GPF

ZGJEDHJET POLITIKE, PS KRYESON ME 54%, PD 36%, LSI NE RENIE

Report TV në bashkëpunim me Institutin Italian GPF Inspiring Research, sjell sondazhin e dytë mbi situatën politike në vend dhe pritshmërinë për zgjedhjet vendore të qershorit. Nëse zgjedhjet e përgjithshme zhvillohen sot socialistët fitojnë sërish të vetëm

ZGJEDHJET VENDORE, PS FITON BASHKITË KRYESORE, DOMINON TIRANËN, PD NË AVANTAZH NË SHKODËR E DIBËR

61.3 % DO MARRIN PJESË NË ZGJEDHJET LOKALE NËSE OPOZITA I BOJKOTON

SHUMICA E SHQIPTARËVE NUK MBËSHTESIN PROTESTAT E OPOZITËS

44 % PRO OFERTËS SË RAMËS NDAJ OPOZITËS PËR REFORMËN ZGJEDHORE

► FAQE 2-3-4

ÇËSHTJA E VIZAVE

Soreca: Shqipëria i ka plotësuar kushtet, Holanda e paqartë

Ambasadori italian Cutillo: Është vendim i Holandës, jo i Bashkimit Europian. Shqipëria meriton hapjen e negociatave

► FAQE 6

LISTA

Shpronësimet për punimet e gazjellësit TAP, emrat dhe kompesimi financiar

► FAQE 10-30

MINISTRI NE REPORT TV

Gent Cakaj: Rrini të qetë! S'ka rikthim vizash me Europën

► FAQE 7

"PAKTI PER UNIVERSITETIN"

QEVERIA MIRATON VKM PER KARTEN E STUDENTIT, DO JEPET FALAS

Çmime të reduktuara nga entet shtetërore. Bashkitë detyrohen të sigurojnë shërbime falas ose me ulje

► FAQE 5

GRABITJA NE RINAS

Dy zyrtarë të TIA në prokurori: Operatorët e kamerave nuk njoftuan në kohë

Gruaja e Admir Murataj, Albana dëshmon në Prokurori: S'dija me kë jetonte e banonte burri

► FAQE 8

NGA ELTON QYNO

ZBATOHET MARRËVESHJA

Kreu një vrasje, gjykata vendos të ekstradojë në Angli shqiptarin

► FAQE 9

KOMBETARJA

Edy Reja merr zyrtarisht drejtimin e Shqipërisë

Trajneri italian në krye të kombëtares deri në fund të eliminatoreve: "Jap 200% për kuqezinjtë". Duka: "Bëmë zgjedhjen e duhur"

► FAQE 32

Cyan magenta yellow black

SONDAZHI I RI I GPF

Zgjedhjet lokale, PS fiton bashkitë kryesore, dominon Tiranën

PS fiton bindshëm në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë dhe Korçë, PD në avantazh në Shkodër dhe Dibër, ja përqindja e mbështetjes për partitë kryesore

Nëse zgjedhjet lokale do të mbaheshin sot, Partia Socialiste do të fitonte bashkitë kryesore. Sipas rezultateve të sondazhit të dytë të institutit italian 'GPF Inspiring Research', në bashkëpunim me Report Tv, nëse zgjedhjet për drejtimin e Tiranës do të zhvilloheshin sot, 63-67 % e qytetarëve do të votonin për PS, 24-28 % për Partinë Demokratike, 6-8 % për LSI, 0-1 % PDIU, 0-1 % Partinë Republikane dhe 0-2 % partitë e tjera. Në raport me sondazhin e parë të 13 marsit 2019, në Tiranë, PS ka pësuar një rënie me 1 %, PD ka një rritje me 4 %, ndërsa LSI dhe partitë e tjera kanë pësuar gjithashtu rënie, përveç PDIU dhe PR që nuk kanë ndryshime në mbështetje. Pas Tiranës, Durrësi është bashkia më rëndësishme në vend. Nëse zgjedhjet do të zhvilloheshin sot, 49-53 % do të votonin për PS, 25-29 % për PD, 10-14 % për LSI, 4-6 % PDIU, 0-1 % PR, 3.5-5.5 % partitë e tjera. Në raport me sondazhin e 13 marsit, PS ka një rënie me 1 %, por pa vënë në diskutim fitoren në Durrës, ndërsa PD ka një rrije me 1 %. LSI ka pësuar gjithashtu një rënie me 4 %. Në Fier, 57-61 % votojnë për PS nga 55-59 % që votonin në sondazhin e parë. Për PD votojnë 22-26 %, për LSI 8.5-12.5 %, për PDIU 3-5 %, për PR 0-1 % dhe për partitë e tjera 1-3 %. Sipas sondazhit, nëse zgjedhjet lokale do të zhvilloheshin sot, në Elbasan, 46-50 % votojnë PS, 21-25 % votojnë për PD, 10-14 % për LSI, 12-26 % për PDIU, 0-2 % për PR dhe 1-3 % për partitë e tjera. Sondazhi konfirmon se PDIU ka një mbështetje më të madhe se sa LSI në Elbasan, ndonëse PDIU ka pësuar një rënie me 3 % krahasuar me sondazhin e parë. Përpos PDIU, krahasuar me sondazhin e parë, rënie ka pësuar e Partia Demokratike në Elbasan me 3 %.

Konkluzioni
Nëse zgjedhjet lokale do të mbaheshin sot, Partia Socialiste do të fitonte bashkitë kryesore, ndërsa PD është në avantazh në Shkodër dhe Dibër.

SHKODRA DHE KUKËSI

Sondazhi konfirmon se Partia Demokratike është në avantazh në Shkodër, në kryeqendrën e veriut. Nëse llogarisim edhe LSI, PDIU dhe PR, që janë në një koalicion me PD, opozita thellon diferencën. Konkretisht, në Shkodër, 38-42 % do të votonin për PS, 41-45 % për PD, 5-7 % për LSI, 2-4 % për PDIU dhe 0-1 % për PR. Ndërkaq, 7.5-9.5 % thonë se do të votonin partitë e tjera, ndërsa 11.7 % janë të pavendosur. Në raport me rezultatet e sondazhit të partë, në sondazhin e dytë PS ka pësuar një rënie me 2 %, PD rritje me 3 % dhe LSI rënie me 2 %. Në Kukës, 47-51 % votojnë për PS, 44-48 % për PD, 2.5-4.5 % për LSI, 0-1 % për PDIU, 0-1 % për PR dhe 0-1 % për partitë e tjera. Në Dibër, 27-31 % të të anketuarve janë shprehur se do të votonin PS, 35-39 % për PD, 12-16 % për LSI, 16.5-20.5 % për PDIU, 0-1 % për PR dhe 2-4 % për partitë e tjera. Në Lezhë, 47-51 % votojnë për PS, 36-40 % për PD, 7-9 % për LSI, 1-3 % për PDIU, 0-1 % për PR dhe 2-3 % për partitë e tjera.

BASHKITË E TJERA

Nëse zgjedhjet do të zhvilloheshin sot në Vlorë, 62-66 % do të votonin për PS, 21-25 % për PD, 4.5-6.5 5 % për LSI, 3-5 për PDIU, 0-1 % PR dhe 2-4 % për partitë e tjera. Krahasuar me sondazhin e parë, PS ka pësuar një rënie me 2 % në Vlorë, por pa e vënë në diskutim fitoren. Në Korçë, 57-61 % votojnë për PS, 24-28 për PD, 9-13 % për LSI, 0-2 % për PDIU, 0-2 % për PR dhe 1-3 % për partitë e tjera. PS, PD, PDIU dhe PR kanë shënuar rritje në Korçë, ndërsa LSI ka pësuar rënie krahasuar me sondazhin e parë. Në Gjirokastër, 46-50 % votojnë për PS, 29-33 % për PD, 15-19 % për LSI, 0-1 % për PDIU, 0-1 % për PR dhe 4-6 5 për partitë e tjera. Sondazhi konfirmon fitoren e PS në Berat. Sipas sondazhit, në Berat, 57-61 % votojnë për PS, 22-26 % për PD, 10.5-14.5 % për LSI, 1-3 % për PDIU, 0-1 % për PR dhe 1-3 % për partitë e tjera. Krahasuar me sondazhin e parë, në Berat, PS ka një rritje me 1 %, PD rritje me 4 %, ndërsa LSI rënie me 3.5 %.

NËSE DO TË VOTONI SOT NË ZGJEDHJE VENDORE, PËR CILËN PARTI DO TË VOTONI?

TIRANË

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX
PS	63	67	↓	64	68
PD	24	28	↑	20	24
LSI	6	8	↓	8	10
PDIU	0	1	=	0	1
PR	0	1	=	0	1
PARTI TE TJERA	0	2	↓	1	3

Të pavendosur: 15.6% -8.2

SHKODËR

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	Kryetari aktual
PS	38	42	↓	40	44	
PD	41	45	↑	38	42	
LSI	5	7	↓	7	9	
PDIU	2	4	↑	0	1	
PR	0	1	=	0	1	
PARTI TE TJERA	7.5	9.5	↓	8	10	

Të pavendosur: 11.7% +4.2

DURRËS

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	Kryetari aktual
PS	49	53	↓	50	54	
PD	25	29	↑	24	28	
LSI	10	14	↓	14	18	
PDIU	4	6	↑	2	4	
PR	0	1	↓	1	3	
PARTI TE TJERA	3.5	5.5	↑	0	2	

Të pavendosur: 38.1% +0.6

KUKËS

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	Kryetari aktual
PS	47	51	=	47	51	
PD	44	48	↑	41	45	
LSI	2.5	4.5	↓	4	6	
PDIU	0	1	=	0	1	
PR	0	1	=	0	1	
PARTI TE TJERA	0	1	↓	1	3	

Të pavendosur: 27.9% -11.3

FIER

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	Kryetari aktual
PS	57	61	↑	55	59	
PD	22	26	↓	24	28	
LSI	8.5	12.5	↑	7	9	
PDIU	3	5	↓	4	6	
PR	0	1	↓	1	3	
PARTI TE TJERA	1	3	=	1	3	

Të pavendosur: 21.6% -6.8

DIBËR

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	Kryetari aktual
PS	27	31	↓	28	32	
PD	35	39	↑	29	33	
LSI	12	16	↑	10	14	
PDIU	16.5	20.5	↓	20	24	
PR	0	1	=	0	1	
PARTI TE TJERA	2	4	↓	3	6	

Të pavendosur: 22.4% +8.8

VLORË

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	Kryetari aktual
PS	62	66	↓	64	68	
PD	21	25	↑	16	20	
LSI	4.5	6.5	↑	3	5	
PDIU	3	5	↓	6	8	
PR	0	1	↓	1	3	
PARTI TE TJERA	2	4	=	2	4	

Të pavendosur: 14.7% -5.7

LEZHË

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	Kryetari aktual
PS	47	51	↓	48	52	
PD	36	40	↑	33	37	
LSI	7	9	↓	10	12	
PDIU	1	3	↑	0	1	
PR	0	1	=	0	1	
PARTI TE TJERA	2	3	↓	2	4	

Të pavendosur: 18.6% +2.8

BERAT

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	Kryetari aktual
PS	57	61	↑	56	60	
PD	22	26	↑	18	22	
LSI	10.5	14.5	↓	14	18	
PDIU	1	3	↓	2	4	
PR	0	1	↓	0	2	
PARTI TE TJERA	1	3	=	1	3	

Të pavendosur: 37.1% -2.5

KORÇË

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	Kryetari aktual
PS	57	61	↑	54	58	
PD	24	28	↑	20	24	
LSI	9	13	↓	16	20	
PDIU	0	2	↑	0	1	
PR	0	2	↑	0	1	
PARTI TE TJERA	1	3	↓	2	4	

Të pavendosur: 18.5% -9.1

GJIROKASTËR

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	Kryetari aktual
PS	46	50	↑	45	49	
PD	29	33	↑	24	28	
LSI	15	19	↓	16	20	
PDIU	0	1	=	0	1	
PR	0	1	=	0	1	
PARTI TE TJERA	4	6	↓	7	9	

Të pavendosur: 29.3% -0.4

ELBASAN

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	Kryetari aktual
PS	46	50	↑	39	43	
PD	21	25	↓	24	28	
LSI	10	14	↑	8	10	
PDIU	12	16	↓	15	19	
PR	0	2	=	0	2	
PARTI TE TJERA	1	3	↓	5	7	

Të pavendosur: 19.3% -3.8

BURIMI: GPF INSPIRING RESEARCH PËR REPORT TV

Sondazhi i dytë

Televizioni Report TV, në bashkëpunim me institutin italian 'GPF Inspiring Research', solli mbrëmë rezultatet e sondazhit të dytë mbi situatën politike në Shqipëri si dhe rreth pritshmërive të shqiptarëve për zgjedhjet vendore të qershorit.

NËSE SOT DO KISHTE ZGJEDHJE TË PËRGJITHSHME TË PARAKOHSHME, PËR KË DO TË VOTOJE?

	SOT MIN	SOT MAX		13/03/2019 MIN	13/03/2019 MAX	ZGJEDHJE 2017
PS	50	54	↑	49	53	48.3
PD	32	36	↑	29	33	28.9
LSI	7	9	↓	9	11	14.3
PR	0	1	=	0	1	0.2
PDIU	2	4	↓	3	5	4.8
FRD	0	1	=	0	1	0.3
PARTI TE TJERA	1	3	↓	2	4	3.2

Burimi: GPF INSPIRING RESEARCH për REPORT TV — Të pavendosur: 26.2%

Zgjedhjet politike, PS kryeson me 54%, PD 36%, LSI në rënie

PS fiton e vetme nëse zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të mbaheshin sot, 61.3 % do marrin pjesë në zgjedhjet lokale nëse opozita i bojkoton

Adriatik Doçi
TIRANE

Televizioni Report TV, në bashkëpunim me institutin italian 'GPF Inspiring Research', solli mbrëmë rezultatet e sondazhit të dytë mbi situatën politike në Shqipëri si dhe rreth pritshmërive të shqiptarëve për zgjedhjet vendore të qershorit. Të dhënat e sondazhit të institutit prestigjioz italian u prezantuan në emisionin 'Repolitix' në Raport Tv. Sondazhi i dytë prodhoi rezultate edhe mbi opinionin e qytetarëve për strategjinë e opozitës, ofertën e kryeministrit Edi Rama ndaj opozitës për miratimin e reformës zgjedhore, qëndrimin e votuesve nëse opozita bojkoton zgjedhjet lokale etj. I ftuar në emision, për të diskutuar mbi rezultatet e sondazhit ishte President i GPF Inspiring Research, Roberto Baldassari, më parë Presidenti Institutit Piepoli.

ZGJEDHJET POLITIKE

Opozita jo parlamentare kërkon krijimin e një qeverie transitore dhe zgjedhje të parakohshme. Po si do të votonin shqiptarët nëse sot do të mbaheshin zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme? Sipas sondazhit të dytë të institutit italian 'GPF Inspiring Research', 50-54 % të të anketuarve në rang kombëtar, kanë votuar për Partinë Socialiste, 32-36 të të pyeturve votojnë Partinë Demokratike, 7-9 % votojnë LSI-në, 0-1 % Partinë Republikane, 2-4 % PDIU-në, 0-1 % FRD-në dhe 1-3 % partitë e tjera politike. Në raport me sondazhin e parë të zhvilluar në datën 13 mars 2019, Partia Socialiste dhe Partia Demokratike rezultojnë me rritje të mbështetjes popullore, rrije e cila është më e theksuar te PD, por që gjithsesi e ndan një hendek i madh me PS. Konkretisht, në sondazhin e 13 marsit, PS merrte 49-53 % të votave, ndërsa PD 29-33 % të votave. Sondazhi i dytë konfirmon rënien e mbështetjes popullore për LSI dhe PDIU, nëse zgjedhjet parlamentare do të zhvilloheshin sot. Në sondazhin e 13 marsit 2019, 9-11 % të të anketuarave kanë votuar për LSI-në, duke pësuar një rënie me 2 %, ndërsa 3-5 % PDIU-në, duke pësuar një rënia me 1 %. Mbështetja për PR dhe FRPD është e njëjtë, ndërsa partitë e tjera kanë pësuar gjithashtu rënie.

Rezultati

Sipas sondazhit të dytë të institutit italian 'GPF Inspiring Research', 50-54 % të të anketuarve në rang kombëtar, kanë votuar për Partinë Socialiste, 32-36 të të pyeturve votojnë Partinë Demokratike, 7-9 % votojnë LSI, 0-1 % PR, 2-4 % PDIU, 0-1 % FRD dhe 1-3 % partitë e tjera politike.

BOJKOTI I ZGJEDHJEVE LOKALE

Shumica e të anketuarave thonë se do të votojnë në zgjedhjet lokale të 30 qershorit 2019, edhe nëse opozita shqiptare i bojkoton zgjedhjet. Sipas sondazhit të institutit italian 'GPF Inspiring Research', 61.3 % të të pyeturve, thonë se do të votojnë në zgjedhjet e lokale të 30 qershorit, edhe nëse partitë opozita nuk marrin pjesë. Ndërkaq, 38.7 për qind të të pyeturve janë shprehur se nuk do të shkojnë për të votuar. Nga 61.3 % që do të marrin pjesë në votime, 58.% % janë shprehur se do të merrnin pjesë në zgjedhje pasi gjithsesi nuk votojnë për opozitën, 32 % janë shprehur se do të marrin pjesë, por nuk kanë vendosur ende se për kë do të votojnë. Nga përqindja e të pyeturve që do marrin pjesë në votime edhe nëse opozita bojkoton zgjedhje, 7.5 % janë shprehur se do të votojnë një forcë tjetër që e mendojnë opozitë, ndërsa 2.3 % janë shprehur se do të votonin fletë të bardhë.

NËSE PARTITË KRYESORE POLITIKE TË OPOZITËS DO TË VENDOSIN TË BOJKOTOJNË ZGJEDHJET VENDORE TË 30 QERSHORIT 2019, ÇFARË DO TË BËNI?

NUK DO TË VOTOJ	38.7%
DO TË SHKOJ TË VOTOJ	61.3%
Do të votoja gjithësesi pasi nuk votoj për opozitën	58.1%
Do të votoj por nuk kam vendosur akoma për kë	32.1%
Do të votoj një forcë tjetër politike që e mendoj opozitë	7.5%
Do të votoj fletë të bardhë	2.3%

BURIMI: GPF INSPIRING RESEARCH PËR REPORT TV

SONDAZHI I RI I GPF

Shumica e shqiptarëve nuk mbështesin protestat e PD-LSI

44% pro ofertës së Edi Ramës ndaj opozitës për reformën zgjedhore, 34.1% kundër, 8.1% duan garanci më të forta, 38% thonë se deputetët e opozitës së re janë legjitimë

SI E GJYKON GJENDJEN E PËRGJITHSHME AKTUALE TË SHQIPËRISË?

	SOT		13/03/2019
POZITIVE	21.2%	↑	12.8%
NEGATIVE	51.1%	↓	55.3%
NORMALE	26.4%	↓	28.4%
NUK E DI	1.3%	↓	3.5%

KRYEMINISTRI RAMA I KA PROPOZUAR OPOZITËS TË REALIZOJË SË BASHKU REFORMËN ELEKTRORALE PËR TË DHËNË KËSHTU TË GJITHA GARANCITË LEGJISLATIVE. SIPAS TEJE OPOZITA DUHET TA PRANOJË KËTË PROPOZIM?

	SOT
Absolutisht PO	44.0%
PO, por opozita duhet të pretendojë garanci më të forta	8.1%
Absolutisht JO	34.1%
Nuk e di/Nuk përgjigjet	13.8%

DERI TANI NJË NUMËR I KONSIDERUESHËM I KANDIDATËVE NË LISTAT E PD DHE LSI KANË PRANUAR TË HYJNË NË PARLAMENT. SIPAS JUSH KËTA DEPUTET TË RINJ JANË LEGJITIM PËR TË PËRFAQËSUAR OPOZITËN?

	SOT
PO, janë absolutisht legjitim	38.0%
JO, nuk janë absolutisht legjitim	36.2%
Ligjërisht janë legjitim, por politikisht gabojnë	21.7%
Nuk e di/Nuk përgjigjet	4.1%

A E MBËSHTET STRATEGJINË E OPOZITËS PËR TË PROTESTUAR NË SHESH?

	SOT
PO, e mbështes	29.6%
PO, e mbështes, por mendoj që protestat duhet të jenë më të dhunshme për të qënë efikase	5.6%
JO, nuk e mbeshtes sepse po humb efikasitetin e saj	17.2%
JO, abslolutisht nuk e mbështes	45.3%
Nuk e di/nuk përgjigjet	2.3%

BURIMI: GPF INSPIRING RESEARCH PËR REPORT TV

Detajet

PROTESTA
Shumica e shqiptarëve nuk mbështesin strategjinë e opozitës shqiptare për të protestuar në sheshe, protesta të cilat janë dënuar nga faktori ndërkombëtar për shkak të dhunës sistematike.

OFERTA E RAMËS
Të pyetur nëse opozita duhet ta pranojë propozimin e kryeministrit Edi Rama për të realizuar së bashku reformën zgjedhore, ku opozita do të marrë të gjitha garancitë legjislative për zgjedhjet, 44 % janë përgjigjur 'pro".

ADRIATIK DOÇI
TIRANE

Shumica e shqiptarëve nuk mbështesin strategjinë e opozitës për të protestuar në sheshe, protesta të cilat janë dënuar nga faktori ndërkombëtar për shkak të dhunës sistematike. Sipas sondazhit të institutin italian 'GPF Inspiring Research', në bashkëpunim me Report Tv, vetëm 29.6 % të të anketuarve janë përgjigjur se mbështesin protestat e PD-LSI. 45.3 % të të pyeturve janë pozicionuar prerë kundër strategjisë së opozitës, për të protestuar. 17.2 % janë shprehur se nuk e mbështesin strategjinë e protestave sepse sipas tyre ka humbur efikasitetin, 2.3 % nuk kanë një përgjigje, ndërsa 5.6 % janë shprehur se mbështesin protestat, por sipas tyre protestat duhet të jenë më të dhunshme, për të pasur efikasitet.

OFERTA E RAMËS

Të pyetur nëse opozita duhet ta pranojë propozimin e kryeministrit Edi Rama për të realizuar së bashku reformën zgjedhore, ku opozita do të marrë të gjitha garancitë legjislative për zgjedhjet, 44 % janë përgjigjur 'pro'. Ndërkaq, sipas sondazhit, 34.1 % të të pyeturve janë përgjigjur kundër pranimit nga PD-LSI të ofertës së Ramës. 8.1 % janë shprehur se opozita duhet ta pranojë ofertën, por duhet të pretendojë garanci më të forta për zgjedhjet. Ndërsa 13.8 % nuk kanë një përgjigje. Ashtu siç shumica e të pyeturve shprehen kundër strategjisë së protestave, shumica janë pro dialogut dhe pranimit të ofertës së kryeministrit, ndonëse 8.1 % e kësaj shumice mendojnë se opozita duhet të kërkojë garanci edhe më të forta.

OPOZITA E RE

Të anketuarit janë pyetur edhe mbi legjitimimin e opozitës së re. Deri më tani një numër i konsiderueshëm i kandidatëve në listat e PD-LSI kanë pranuar të marrin mandatin e deputetit dhe të hyjnë në Kuvend, kundër vullnetit të partive të tyre. 38 % thonë se deputetët e rinj janë legjitimë. 21.7 % mendojnë se ligjërisht janë legjitimë, por politikisht kanë gabuar. 36.2 % mendojnë se nuk janë legjitimë, ndërsa 4.1 % nuk kanë një përgjigje.

SITUATA POLITIKE

Të pyetur mbi situatën aktuale politike në Shqipëri, 51.1 % e të anketuarve e perceptojnë si negative. Krahasuar me sondazhin e 13 marsit 2019, përqindja e personave që e perceptojnë situatën negative është më ulët. Në sondazhin e 13 marsit, 55.3 e të pyeturve e perceptonin situatën politike në vend si negative. Ndërsa 26 % e të pyeturve janë shprehur se situata politike është normale, në raport me 28.4 në sondazhin e 13 marsit 2019. 21.2 % e të pyeturve janë shprehur se situata politike është pozitive, në raport me 12.8 % në sondazhin e 13 marsit. Ndërkaq, 1.3 % nuk kanë një përgjigje.

Presidenti i GPF

Baldassari dhe parashikimet e sakta në 2013 dhe 2017

Presidenti i "GPF Inspiring Research", Roberto Baldassari, është i njohur nga publiku shqiptar, pas parashikimeve të sakta që bëri për zgjedhjet e vitit 2015 dhe 2017 me institutin "Piepoli". Asokohe Roberto Baldassari ishte President i institutit "Piepoli". Në 2017, sondazhi i institutit "Piepoli", me ish-president, Roberto Baldassari, parashikoi fitoren e Partisë Socialiste, si forcë e vetme politike. Konkretisht, sondazhi i institutit "Piepoli" parashikoi që PS merrte e vetme deri në 73 mandate. PS mori në zgjedhje 74 mandate.

Ky parashikimi, i cili rezultoi i saktë, prodhoi reagime të forta nga politika, sidomos nga Lëvizja Socialiste për Integrim, e cila pretendoi se do të merrte 34 mandate në zgjedhjet e 2017. Instituti "Piepoli" parashikoi se LSI do të merrte deri në 17 mandate, sigurisht gjithnjë me një marzh të caktuar gabimi, parashikim ky që u përputh me rezultatin e LSI në zgjedhje.

"PAKTI PER UNIVERSITETIN"

Qeveria miraton VKM për Kartën e Studentin, do jepet falas

Çmime të reduktuara në të gjitha shërbimet që ofrohen nga entet shtetërore. Bashkitë detyrohen të sigurojnë edhe ato shërbime falsa ose me ulje

Qeveria shqiptare ka vendosur dje që të gjitha njësitë vendore të nisin punën për kartën e studentit. Sipas vendimit të qeverisë, prodhimi dhe pajisja e studentëve me karta do të bëhet falas nga qeveria. Po kështu qeveria nëpërmjet ministrisë së Arsimit merr përsipër edhe shërbimet që janë në nivel kombëtar. "Përfituesit e kartës së studentit përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara edhe nga subjekte të tjera publike apo private, që kanë objekt të fushës së veprimtarisë së tyre shërbime për studentët, në bazë të marrëveshjeve përkatëse, pa efekte financiare për buxhetin e shtetit, të nënshkruara me ministrinë përgjegjëse për arsimin", thuhet në vendim. Ndërsa për ato në nivel vendor do të jenë bashkitë përkatëse që duhet të sigurojnë të gjitha shërbimet me çmim të reduktuar ose falas për të gjithë studentët, njësoj si Bashkia e Tiranës.

Duke ecur në vazhdën e plotësimit të "Paktit për Universitetin", ku një nga pikat kryesore ishte Karta e Studentit, në mbledhjen e djeshme u mor vendimi që qeveria shqiptare do të marrë përsipër prodhimin e kartës së studentit falas, e ndërsa të gjitha Bashkitë do të kenë për detyrë garantimin e të gjitha shërbimeve me çmim të reduktuar për studentët. "Shërbimet që ofrohen nga entet shtetërore në fushën e artit dhe të kulturës, të shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit, si një dokument unik i çdo student", thuhet në VKM, duke sqaruar gamën e shërbimeve që do të përfitojnë studentët.

Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, të gjitha njësitë vendore do të duhet të nënshkruajnë marrëveshje me ministrinë e Arsimit për ofrimin e shërbimeve me çmim të reduktuar, të cilat do të përballohen nga buxhetet e njësive vendore. Këto të fundit kanë si detyrë të nënshkruajnë marrëveshje me subjeket publike dhe private për ofrimin e shërbimeve me çmim të reduktuar për studentët. Marrëveshjet e lidhura, do të marrin miratim paraprak nga Ministria e Arsimit, e cila konfirmon miratimin brenda 10 ditëve. Studentët me anë të paraqitjes së kartës pranë këtyre shërbimeve, i përfitojnë ato me çmim të reduktuar.

Nga ana tjetër, në vendimin e qeverisë theksohet se qendra e Shërbimeve Arsimore konfirmon, për çdo vit akademik, studentët e regjistruar në vitin përkatës akademik, për çdo institucion të arsimit të lartë. Ditën e martë Bashkia e Tiranës prezantoi kartën e studentit e cila pritet të jetë gati në muajin maj. Erion Veliaj së bashku me ministren e Arsimit Besa Shahini prezantuan 40 shërbimet publike dhe private të cilat do t'i ofrohen me çmim të reduktuar ose falas të gjithë studentët.

Bulevardi i ri

Bregu i Lumit, përplasje mes banorëve e ish-deputetëve me policinë

Vijimi i shembjes së banesave në zonën e Bregut të Lumit për t'i hapur rrugë zgjatimit të projektit të Bulevardit të Ri ne Tiranë, është shoqëruar këtë të mërkurë me përplasje mes forcave të policisë prezente për të mbështetur IKMT-në, banorëve të cilët u shemben ndërtesat dhe dy ish-deputetëve; Klevis Balliut të Partisë Demokratike dhe Endrit Braimllarit të Lëvizjes Socialiste për Integrim. Pavarësisht rezistencës së banorëve dhe ish-deputetëve forcat e rendit kanë bërë të mundur që të vijojë puna për shembjen e ndërtesave. Kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj komentoi edhe përpjekjet e opozitës për të bllokuar ndërtimin e Bulevardit të Ri, që do të jetë boshti i asaj që nesër do të quhet Tirana e së ardhmes. Veliaj deklaroi se politikanët e llastuar dhe të fortët e politikës shqiptarë nuk mund të bllokojnë ndryshimin. Në Bregun e Lumit janë parashikuar të prishen 38 banesa. Këtë të mërkurë nisi prishja e 15 shtëpive. Disa prej qytetarëve janë shprehur se nuk janë dëmshpërblyer për prishjen e banesave, e ndërsa disa të tjerë refuzojnë të heqin dorë nga banesat e tyre. Projekti për Bulevardin e Ri, është cilësuar më herët nga kryebashkiaku Erion Veliaj vendi ku do të projektohet e ardhmja e Tiranës.

VENDIMI I QEVERISË

Eduart Makri zgjidhet kryetari i Qendrës së Kinematografisë

Pas garës për drejtues në Qendrën Kombëtarë të Kinematografisë është shpallur fituesi, i cili është regjisori Eduard Makri. Përballë tij kandiduan edhe artistja Yllka Gjollesha, producentja Elkjana Gjipali dhe kineasti Ilir Butka (ish-drejtues i QKK). Ndërsa, dy emrat që ministrja e Kulturës, Elva Margariti rekomandoi në qeveri ishin ai i Ilir Butkës dhe Eduart Makrit. Eduart Makri (1957) lind në qytetin e Gjirokastrës. Pas përfundimit të studimeve të larta në Institutin e Lartë të Arteve (sot Akademia e Arteve) në degën e Aktrimit fillon punën në Kinostudion "Shqipëria e Re" si regjisor dhe skenarist. Në vitin 1993 fillon punën si pedagog në Akademinë e Arteve. Në vitin 1997 u zgjodh Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit të Kulturës dhe Arteve "Fan Noli". Në vitin 1997 u emërua Drejtor i Departamentit të Filmit dhe Spektaklit në Televizionin Publik Shqiptar. Në vitin 2000 largohet për në Kanada. Në teatër ai ka interpretuar disa role me trupën e Teatrit Të Instituti të Lartë të Arteve (sot Akademia e Arteve). Në kinematografi roli i tij i parë si aktor do të jetë ai i Vasos në filmin "Vëllezër dhe shokë" në vitin 1980. Më tej do të vazhdonin interpretime të tjera si ai në rolin e Aristotelit në filmin televiziv "Agimet e Stinës së Madhe", Gjergji në filmin "Besa e kuqe", Andrea në filmin "Në emër të lirisë", Pirro në filmin "Shpresa"etj. Ka punuar edhe si regjisor.

Me vendosjen e tij në qytetin e Torontos (Kanada) ai do të vazhdojë profesionin e tij.

BSA
Bailiff Services Albania

NJOFTIM

Shoqëria Përmbarimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k, me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-1, të pasurisë së paluajtshme në pronësi të Z.Erand Curra , Znj.Enertila Curra dhe Znj.Aferdita Lamçaj, lënë garanci për "Alpha Bank Albania" sh.a

-NË DATË 29.04.2019 ORA 16:00.
-"Apartament" nr. pasurie 5/407+1-52, Vol.40, Fq.72, ZK.8534, me sip.88.17 m² me adrese lagja "Kastriot", Fier ne bashkepronesi te Z.Erand Curra dhe Znj.Enertila Curra, me çmimin fillestar 4,000,000 leke.
-"Njesi" nr. pasurie 5/365-N2, Vol.28, Fq.65, ZK.8534, me sip.17.3 m² me adrese lagja "Kastriot", Fier ne pronesi te Znj.Aferdita Lamçaj , me çmimin fillestar 2,1824,000 leke.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com

PROJEKTI

Shqipëri-Gjermani, marrëveshje për programin sektorial të ujërave

Ministria e Infarstrukturës dhe Energjisë ka nënshkruar një marrëveshje mes Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për furnizimin me ujë të zonave rurale bregdetare, i cili do ti shërbejë rreth 80 mijë banorëve e turistëve. Ky projekt sipas ministres Belinda Balluku do të sjellë furnzim me ujë të pijshëm në zonat rurale dhe veçanërisht në bregdet, ku është parashikuar gjithashtu edhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimeve duke ndikuar në këtë mënyrë në zhvillimin e turizmit. Zhvillimi i turizmit si sektor kyç, është i rëndësshëm dhe ky ndryshim rrënjësor në infrastrukturë në zonat turistike sipas ambasadores gjermane Schütz, do të sjellë përmirësim të cilësisë së ujit në 160 fshatra. Projketi 'Furnizimi me ujë i zonave rurale 4' ka një vlerë 42 mln euro.

DEBATI / MINISTRI I JASHTËM HOLANDEZ KUNDËR PARLAMENTIT

KE: S'kemi asnjë kërkesë nga Holanda për vizat

Bertaud
"Komisioni është në dijeni për mocionin që kaloi dje në parlamentin holandez, por ekziston një procedurë specifike për mekanizmin e rikthimit të vizave. Deri më sot nuk kemi marrë asnjë njoftim nga asnjë shtet anëtar që kërkon që rikthimin e vizave".

Zëdhënësja e Komisionit Europian, Natasha Bertaud, ka deklaruar dje se nuk ka mbërritur asnjë kërkesë nga Holanda që kërkon rikthimin e vizave me Shqipërinë. Në një deklaratë për mediat, Bertaud konfirmoi se është në dijeni për mocionin në parlamentin holandez, por theksoi se është një procedurë fikse për rikthimin e vizave për një shtet të caktuar, e cila deri më tani nuk ka nisur. "Komisioni është në dijeni për mocionin që kaloi dje në parlamentin holandez, por ekziston një procedurë specifike për mekanizmin e rikthimit të vizave. Deri më sot nuk kemi marrë asnjë njoftim nga asnjë shtet anëtar që kërkon që rikthimin e vizave për një shtet tjetër", tha Natasha Bertaud. Ministri i Jashtëm holandez Stef Blok është shprehur kundër vendimit të parlamentit për t'i propozuar Komisionit Evropian rikthimin e vizave për shqiptarët. Në përgjigje të ligjvënësve të ekstremit të djathtë që kërkuan rivendosjen e vizave për shqiptarët, ai ka thënë se nuk parashikon ta paraqesë në Bruksel mocionin e parlamentit. Gjatë diskutimeve në Parlament, ministri i Jashtëm holandez Staf Blok, por dhe ai i Brendshëm Ferdinand Grapperhaus mësohet se e kanë kundërshtuar kërkesën. Edhe pse shifrat zyrtare holandeze flasin për shifra që vijnë në ulje sa i takon kriminalitetit të shqiptarëve, dukë zënë vetëm 0.2% të të dyshuarve, ekstremistët tani që janë në përudhë zgjedhjesh, kërkojnë të përfitojnë politikisht me të tilla teza populiste. Grapperhaus ishte vetëm pak javë më parë në Tiranë dhe në konferencën e tij për shtyp me ministren shqiptare të Drejtësisë Etilda Gjonaj foli me tone pozitive për ecurinë e Shqipërisë në procesin e integrimit evropian si dhe për bashkëpunimin edhe me autoritetet policore shqiptare.

Soreca: Shqipëria i ka plotësuar kushtet, Holanda e paqartë

Ambasadori italian Alberto Cutillo: Është vendim i Holandës, jo i Bashkimit Europian. Shqipëria meriton hapjen e negociatave

Ambasadori i Bashkimit Europian në Shqipëri, Luigi Soreca, është shprehur se Shqipëria i ka plotësuar të gjitha kërkesat në lidhje me vizat dhe se asgjë nuk ka ndryshuar. Parlamenti i Holandës, me një shumicë të pazakontë prej 2/3 (108 Vota Pro, 42 Vota Kundër) votoi ditën e martë "pro" propozimit të 5 partive parlamentare (VVD, CDA, PVV, SP dhe CU), për t'i kërkuar Komisionit Evropian që të rikthejë regjimin e vizave për Shqipërinë me argumentin se emigracioni i paligjshëm i shqiptarëve në Holandë ka sjellë rritjen e krimit. Por, Soreca e vlerëson këtë pretendim si të pabazuar në fakte. Ai ka deklaruar se qeveria holandeze nuk është shprehur qartë se ka një lidhje mes emigrimit të paligjshëm dhe krimit. "Një gjë e tillë është bërë katër muaj më parë. Ky ka qenë një raport i KE për të parë ecurinë e pezullimit të mekanizmit të vizave. Në raportin e dhjetorit Komisioni konfirmoi se Shqipëria ka plotësuar të gjitha kriteret për udhëtimin pa viza. Në të njëjtin raport KE ka identifikuar dhe masat që duhet të marrë Shqipëria në fushën e emigracionit të paligjshëm dhe krimit të organizuar. Që prej atij raporti është shumë e qartë për qeverinë shqiptare se çfarë masash duhet të marrë. Kemi një rregullore për këtë çështje dhe në bazë të kësaj një raport tjetër do të kryhet në dhjetor 2019. Në atë moment bëhet e ditur nëse Shqipëria ka plotësuar ato masa që i ishin lënë një vit më parë. Tani KE do të bëjë vlerësimin e vet në rast se qeveria holandeze sjell raportin e vet. Është vetë qeveria holandeze që në debatin në parlament ka thënë se nuk ka një lidhje të qartë mes udhëtimit pa viza dhe krimit të organizuar. Duhen të dhëna për ta vërtetuar këtë lidhje", tha Soreca. Ambasadori i BE theksoi se udhëtimi pa viza i shqiptarëve në zonën Shengen do të vijojë. Duke e cilësuar heqjen e vizave në vitin 2010, si një ndër arritjet më të mëdha të Shqipërisë, Soreca u shpreh i bindur se pas këtij propozimi, qeveria shqiptare do të marrë masat e duhura, duke vënë në pah nevojën për të rritur bashkëpunimin me Holandën për këto dy çështje. "Asgjë nuk ka ndryshuar, Shqipëria do të vijojë lëvizjen pa viza. Ne i bëjmë thirrje dhe ftojmë si qeveria shqiptare dhe atë holandeze që të intensifikojnë bashkëpunimin. Udhëtimi pa viza është një arritje fantastike për Shqipërinë. Jam i bindur që autoritetet shqiptare do të marrin të gjitha masat që të ruhet kjo arritje", tha Soreca.

Soreca
"Në raportin e dhjetorit Komisioni konfirmoi se Shqipëria ka plotësuar të gjitha kriteret për udhëtimin pa viza. Në të njëjtin raport KE ka identifikuar dhe masat që duhet të marrë Shqipëria në fushën e emigracionit të paligjshëm dhe krimit të organizuar".

Cutillo
"Është një kërkesë dhe vendosje e Parlamentit holandez dhe do të jetë qeveria ajo që do të bëjë kërkesën në BE. Ne dimë që KE çdo vit bën vlerësime, ky vlerësim është bërë pak muaj më parë dhe për Shqipërinë janë dhënë rezultate pozitive".

Borchardt:
"Qeveria legjitime! Opozita të marrë pjesë në zgjedhjet"

Ambasadori i OSBE-së në Tiranë Bernd Borchardt është përfaqësuesi i radhës nga ndërkombëtarët që i bën sërish thirrje opozitës që të marrë pjesë në zgjedhjet lokale të 30 qershorit. Sipas njoftimit të zyrës së shtypit të Kuvendit, Bernd Borchardt gjatë takimit me Gramoz Ruçin, ishin të një mendjeje se Kuvendi dhe qeveria janë plotësisht legjitimë, të dalë nga zgjedhje të rregullta, të certifikuara nga vetë komisionerët e opozitës dhe raportet e OSBE-ODIHR dhe se e ardhmja e vendit dhe konsolidimi i sistemit demokratik kërkojnë që të gjitha forcat politike të marrin pjesë në zgjedhjet lokale të 30 qershorit, ndërsa reforma zgjedhore konsensuale të përfundojë para zgjedhjeve të parlamentare të vitit 2021. Gjithashtu u bisedua edhe mbi zgjerimin e bashkëpunimit midis Kuvendit të Shqipërisë dhe Prezencës së OSBE-së. Bashkëpunimi i deritanishëm përfshin kontributin e Prezencës për fuqizimin dhe modernizimin e shërbimeve të Kuvendit, përmirësimin e infrastrukturës për shërbimin e deputetëve ndaj qytetarëve në territor, përmirësimin e Rregullores dhe të procedurave të Kuvendit etj.



AMBASADORI ITALIAN

Ambasadori italian në Tiranë Alberto Cutillo, duke komentuar vendimin e parlamentit holandez, është shprehur se ky është një vendim i Holandës dhe jo i BE. Për sa i përket hapjes së negociatave Cutillo shprehet se Shqipëria e meriton hapjen e negociatave. "Mekanizmat në bazë të të cilave BE vendos për heqjen apo jo të vizave është shumë ekzakte dhe e detajuar. Është një e drejtë e të gjithë anëtarëve që të kërkojnë verifikime. E djeshmja është një kërkesë dhe vendosje e Parlamentit holandez dhe do të jetë qeveria ajo që do të bëjë kërkesën në BE. Ne dimë që KE çdo vit bën vlerësime, ky vlerësim është bërë pak muaj më parë dhe për Shqipërinë janë dhënë rezultate pozitive dhe ne presim që kur të bëhet vlerësimi në fund të vitit të ketë rezultate pozitive. Vendimi i Holandës nuk mendoj se do të ndikojë tek vendet e tjera anëtare. Shteti italian nuk e sheh këtë problem të rritjes së kriminalitetit për të hequr vizat, ne se kemi parë këtë problem. Për sa i përket hapjes së negociatave për ne Shqipëria e meriton hapjen e negociatave, por politika duhet të punojë për çuarjen përpara të reformave. Nëse e gjithë klasa politike do të bashkëpunonte reformat do të bëheshin më shpejt dhe kjo është ftesa ime, kontribuoni për të mirën e vendit", tha Cutillo.

KËRKESA / PS E HAPUR TË DISKUTOJË PËR NDRYSHIMIN E SISTEMIT

PS plotëson kërkesën e opozitës së re për reformën zgjedhore

KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste

Nr.____Prot. Tiranë më ___/___2019

Lënda: Kërkesë për kryerjen e ndryshimeve në Vendimin e Kuvendit nr. 102/2017 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore", të ndryshuar""

Drejtuar:
Z. Gramoz RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Me qëllim realizimin e objektit të krijimit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për realizimin e Reformës Zgjedhore" dhe përfundimin e punës për miratimin e ndryshimeve të kuadrit ligjor zgjedhor për trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it për tre zgjedhjet e fundit të vitave 2013, 2015 dhe 2017, si dhe propozimet e ndryshime së partive politike në vend, propozoj kryerjen e disa ndryshimeve në këtë Vendim, si më poshtë vijon:

1. Pjesë e objektit të veprimtarisë të Komisionit, të shtohen edhe çështjet e sistemit zgjedhor në Shqipëri
2. Objekti i veprimtarisë të Komisionit të mund të realizohet me disa faza, të cilat mund të përfshinë pjesë të ndryshme të Reformës Zgjedhore.
3. Afati i veprimtarisë të Komisionit të zgjatjet deri në datën 28 nëntor 2019.

Me konsideratë.

Taulant Balla
Kryetar i Grupit Parlamentar

Socialistët pranojnë të diskutojnë edhe ndryshime të sistemit zgjedhor në Shqipëri, pas këmbënguljes së deputetëve të rinj të opozitës, se nuk do të uleshin në komisionin e reformës zgjedhore pa u plotësuar ky kusht. Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla i ka dërguar një letër Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi ku i kërkon ndryshime në vendimin për Komisionin e Reformës Zgjedhore. Kreu i Grupit Socialist, Balla kërkon që afati i Komisionit të Reformës Zgjedhore që është deri më 5 maj të zgjatet deri në 28 nëntor dhe pjesë e veprimtarisë së Komisionit, të shtohen edhe çështjet e sistemit zgjedhor në Shqipëri. Në projektvendim thuhet se puna për reformën zgjedhore mund të realizohet me disa faza, duke konfirmuar se gjithsesi ndërhyrja në sistem do të diskutohet vetëm pas zgjedhjeve lokale. Megjithëkëtë, kjo kërkesë e Ballës mundëson vetëm që deputetët e rinj të opozitës të bashkohen në tryezën e reformës zgjedhore, por nuk është një hap përpara për zgjidhjen e krizës politike. Kjo, pasi vetë PS është shprehur që nuk do të ndryshojë sistemin zgjedhor pa dakordësinë e Partisë Demokratike. Kryeministri Edi Rama i ka shtrirë dorën e dialogut opozitës, për miratimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, me të gjithë sugjerimet e Lulzim Bashës. Por, ky i fundit ka refuzuar, ndërsa ka pohuar se nuk do të ketë zgjedhje me Ramën kryeministër dhe pa opozitën.

DEKLARATA

Kryemadhi: Vendimi i Holandës vulosi i dështimin e Ramës

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Monika e Kryemadhi e ka cilësuar vendimin e parlamentit holandez, për t'i propozuar Komisionit Evropian, rikthimin e vizave për shqiptarët, si një tregues të dështimit të qeverisë shqiptare. "Debati dhe vendimmarrja e djeshme e Parlamentit Holandez për t'i propozuar Komisionit Europian kthimin e regjimit te vizave për shtetasit shqiptarë është një goditje e rëndë për rrugëtimin evropian të Shqipërisë dhe për mundësinë e mohimit të një të drejtë të fituar me shumë sakrifica 10 vite më parë, siç është e drejta e lëvizjes së lirë pa viza drejt hapësirës Shengen. Motivacioni i këtij mocioni është edhe më i rëndë. Pasi ai ka të bëjë me cënimin e sigurisë kombëtare të Holandës, nëpërmjet shtimit të grupeve kriminale me origjinë shqiptare dhe veprimtarisë së tyre në atë vend. Ky votim nga Parlamenti Holandës jo vetëm i vë vulën dështimeve te paprecedenta të qeverisë aktuale, por sinjalizon fortë nivelin e ulët të përgatitjes që e bën të pamundur Shqipërinë të përballojë sfidat e rrugëtimit evropian", tha Kryemadhi. Nga selia e kuqe, Kryemadhi tha se nuk janë protestat e opozitës apo djegia e mandateve që e krijojnë këtë problem shqetësues, por dështimi i qeverisë drejtuar nga Rama. "Parlamenti Holandez konfirmon plotësisht faktin se nuk janë protestat e opozitës dhe djegia e mandateve arsyet e mosçeljes së negociatave, por ajo për të cilën ulërin më shumë se kushdo tjetër është kapja e shtetit, keqqeverisja dhe kapja e gjithë institucioneve nga krimi i organizuar. Ashtu siç e ka theksuar dhe raporti i DASH, Shqipëria është baza operacionale e organizatave të krimit të organizuar. Jo djegia e mandateve, apo protestat e opozitës krijojnë këtë problem, por janë kriteret e paplotësuara nga keqqeverisja e Edi Ramës, nga keqqeverisja e tij. Nga dështimi i institucioneve shqiptare për të bashkëpunuar me institucionet e rendit në Evropë dhe për të krijuar kredibilitetin e duhur për konsolidimin e progresit me rezultate të prekshme dhe konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", tha Kryemadhi.

Gent Cakaj në Report Tv: Rrini të qetë! S'ka rikthim vizash

Erion Braçe S'ka betejë të Holandës, por të Lulzim Bashës kundër shqiptarëve

Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme Gent Cakaj ishte i ftuar në studion e Report Tv pas vendimit të parlamentit holandez për t'i kërkuar Brukselit që të rikthejë vizat për shqiptarët, për shkak të rritjes së kriminalitetit. Ministri garantoi shqiptarët se nuk do të ketë kthim vizash. "Dua të sqaroj se nuk do të ketë tërheqje të vizave për shqiptarët, pasi nuk janë kushtet teknike. Vendimi i parlamentit është propozim për qeverinë dhe qeveria duhet t'i adresohet Komisionit Europian. Një vendim i tillë është i motivuar politikisht, rezultati i zgjedhjeve të fundit rajonale në Holandë ka shfaqur më shumë populizëm dhe euroskepticizëm dhe tani janë zgjedhjet e PE. Kjo është prapavija politike. Heqja e vizave është e pamundur. Qëndrimet politike janë të motivuara mbi kalkulimet elektorale. Pas momentit të zgjedhjeve, të majit dhe publikimit të raportit të progresit, ku presim rekomandim të pakushtëzuar edhe disponimi i vendeve anëtare do të ndryshojë, do të jetë pritshëm në favor të Shqipërisë. Arbitri më i lartë për interpretim të Shqipërisë është KE, në presim rekomandim pozitiv", tha Cakaj.

ERJON BRAÇE

Zv/kryeministri i Shqipërisë Erjon Braçe deklaron se nuk ka betejë të Holandës kundër shqiptarëve, por betejë të Lulzim Bashës kundër shqiptarëve. Ai thotë se vizat nuk do të rikthehen për shqiptarët. Braçe shprehet se kërcënimet e Bashës se do të ketë të tjera vende që do të marrin të njëjtin vendim dështmon ecejaket e tij në zyrat politike të partive të ekstremit të djathtë e deri raciste, janë beteja e tij e përditshme kundër shqiptarëve. "Nuk ka betejë të Holandës kundër shqiptarëve! Ka beteje të Lulzim Bashës kundër shqiptarëve! Pas qëndrimit dje të qeverisë së Holandës. Pas qëndrimit sot të delegacionit të KE në Tiranë. Pas qëndrimit sot të Komisionit Evropian. Të gjithë bashkë: Nuk rikthehen vizat për shqiptarët; Dëshmon në mënyrë të qarte se: Ka një betejë kriminale të Lulzim Bashës kundër shqiptarëve! Lulzim Basha ju ka shpallur luftë!", shkruan Braçe.

Deklarata

Spaho: Basha, holandezi që do i hajë kokën Ramës

Ditën e martë, populistët holandezë kanë kërkuar kthimin e vizave për shqiptarët. Pas këtij akti të tyre, ka reaguar e lumtur edhe PD-ja, ku teksa kërcënon Ramën me Holandën, e nxjerr Lulzim Bashën holandez. Me anë të nënkryetarit Edmond Spaho, duke iu referuar këtij fakti, por edhe humbjes së Juventusit ndaj Ajaxit te Amsterdamit nënkryetari i PD shprehet: 'Edi Rama, holandezët do të ta hanë kokën. Ajaks, Holanda dhe Lulzim Basha.'

DEPUTETËT E PS

Deputetët e mazhorancës e kanë cilësuar vendimin e parlamentit holandez për vizat si një çështje të tyre të brendshme që nuk do të ndikojë në lëvizjen e lirë. Sipas deputetëve, Shqipëria ka bërë progres në sfidat e lëna si detyrë nga Këshilli i Evropës. Deputeti Ervin Bushati thotë se nuk beson që kjo kërkesë e Holandës do të gjejë mbështetjen nga vendet e tjera të Bashkimit Evropian në KE. "Këto janë procese politikë në shumë vende të Evropës, sot kemi shumë parti euroskeptike, populiste, që kanë axhendën e tyre. Janë çështje të brendshme të politikave të vendeve të Evropës, nuk ka të bëjë me Shqipërinë, nuk prezanton dhe nuk ka asnjë argument ligjor këtë e thotë edhe qeveria holandeze". Deputetja e PS Mimi Kodheli u shpreh se ky është një problem i brendshëm politik dhe se nuk preket integrimi i Shqipërisë. Ndërsa zv.ministrja e Brendshme, Rovena Voda pohoi se shifrat e kriminalitetit dhe azilkërkuesve janë ulur.

Dy zyrtarë të TIA në prokurori: Operatorët e kamerave s'njoftuan në kohë

Gruaja e Admir Murataj, Albana dëshmon në Prokurori: S'dija me kë jetonte e banonte burri



Elton Qyno
TIRANE

Albana Murataj, bashkëshortja e Admir Murataj dhe dy zyrtarë të lartë të sigurisë në "Tirana Aeroport" janë marë në pyetje nga prokuroria e Krimeve të Rënda. Gruaja e Murataj ka sqaruar oficerët se kishte kohë që nuk takohej me Admirin, dhe nuk kishte asnjë informacion për shoqërinë e tij dhe vendet ku ai qëndronte. Ndërkohë pas dëshmisë së saj, në prokurori janë paraqitur dhe kanë dhënë shpjegime dy zyrtarë të lartë të TIA, që kanë për detyrë menaxhimin e sigurisë në aeroport. Ata kanë sqaruar procedurën e sigurisë dhe pse nuk kishin dhënë në kohë alarmin për futjen në piste të njerëzve dhe mjeteve të pa autorizuar. Por sipas dëshmisë së dy zyrtarëve, sinjalin fillestar duhet të lëshonte salla e monitorimit të kamerave, në të cilën punojnë disa operatorë. Ndërkohë nga ana tjetër ata kanë treguar në prokurori se dera nga kanë hyrë autorët, konsiderohet si derë emergjence, pasi nga andej mund të hyjnë ambulance dhe zjarrfikse në rast fatkeqësie. Edhe pilotat elektrike sipas tyre ishin vendosur dy, duke u shoqëruar nga dy blloqe betoni, me qëllim shmangien e çdo avaraie elektrike, që mund të sillte bllokimin e hyrjes së zjarrfikësve dhe ambulancave në pistën e aeroportit. Stafi i shoqërisë "ICTS Albania" që është ngarkuar për të siguruar rendin dhe qetësinë e aeroportit "Nënë Tereza" rezulton të mos ketë bashkëpunuar në kohë më policinë e Shtetit. Kjo pasi gjatë analizimit të kamerave filmike ka dalë qartë se operatorët e sallës së monitorimit të kamerave nuk kanë dhënë në kohë alarmin, duke mos raportuar në kohë efektivët e policisë që ndodheshin shumë afër. Kamerat e sigurisë së aeroportit kanë filmuar gjithçka, por ajo që çedoi dhe që ngjall vërtete dyshime për abuzim me detyrën është faktori njerëzor që nuk ka bërë detyrën, duke raportuar në kohë ngjarje. Sipas burimeve të prokurorisë, komandoja e përbërë nga katër vetë dhe e maskuar me një furgon të bardhë me mbishkrimin "Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve" dhe "Hetimi Tatimor" është filmuar në çdo veprim që grabitësit kanë kryer, por çuditërisht monitoruesit e kamerave nuk kanë raportuar situatën e pakëndshme, që po zhvillohej tek njëra nga dyert e emergjencës, nga e cila futesh në pistën e avionëve. Tropojani Admir Murataj së bashku me katër bashkëpuntorët e tij, janë filmuar duke tërhequr zvarë me furgon barrierën e betonit, që bllokonte kalimin. Pas këtij filmimi, sërisht nga kemarat njëri prej tyre ka prerë zinxhirin bllokues të derës me gërshërë çeliku dhe më pas gjithcka ka qënë e lirë për të hyrë në pistë. Mirëpo edhe pse këto veprime janë filmuar çdo sekondë nga kamerat, nga ana e stafit të sigurisë së aeroportit, nuk është dhënë asnjë alarm i kuq, për Policinë e Shtetit që ndodhej aty pranë. Gjithmonë sipas burimeve të prokurorisë, stafi i sgurisë i shoqërisë "ICTS Albania", nuk ka reaguar edhe kur furgoni i bardhë i autorëve, ka hyrë brenda në aeroport por sinjali i kuq dhe njoftimi i policisë është dhënë vetëm kur pesë persona të armatosur janë parë në avjon, teksa rrëmbejnë thasët me para nga hambari i tij dhe i fusin në furgon, e më pas largohen.

VRASJE, VJEDHJE E LËNDË NARKOTIKE

Interpol Tirana ekstradon 3 shtetas shqiptarë të shpallur në kërkim

